



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. _____/2019

PËR

DISA SHITESA NË AKTIN NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR.4,
DATË 9.7.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR PRIVATIZIMIN DHE DHËNIEN NË PËRDORIM SHOQËRIVE
TREGTARE DHE INSTITUCIONEVE SHTETËRORE TË
NDËRMARRJEVE APO OBJEKTEVE TË VEÇANTA, MJETEVE
KRYESORE DHE MJETEVE TË XHIROS SË KËTYRE
NDËRMARRJEVE”, MIRATUAR ME LIGJIN NR.9967,
DATË 24.7.2008, DHE NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.3/2015

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në aktin normativ, me fuqinë e ligjit, nr.4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr.9967, datë 24.7.2008, dhe ndryshuar me ligjin nr.3/2015, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 2 bëhen shtesat, me këtë përmbajtje:

1. Në paragrafin e dytë, në fjalinë e parë, pas fjalës “... tenderit ...” shtohen fjalët “... ose tjetërsimit ...”.
2. Pas paragrafit të dytë shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Kalimi i pronës shtetërore në private të bëhet edhe në funksion të planeve të përgjithshme vendore, sipas kushteve dhe kritereve që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Vendimi i Këshillit të Ministrave, për këto raste, përcakton gjithashtu kushtet që duhet të plotësojnë kërkuarit e tjetërsimit me kontratë të pronës shtetërore, mënyrën e vlerësimit të pronës shtetërore si dhe organet që përfshihen gjatë procesit dhe rolin e tyre.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI